





„Forcimi i kapacitetit institucional të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në rrugën drejt anëtarësimit të saj në SEBQ”

- ❖ Periudha e implementimit, i përfunduar më 14 mars 2021
- ❖ Aktivitetet në tremujorin e fundit të projektit, nga 15 dhjetori i vitit 2020 deri më 14 mars të vitit 2021

PËRFUNDIM I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Implementimi i projektit të binjakëzimit u përfundua me sukses me arritjen e qëllimeve të përgjithshme dhe specifike të projektit, si dhe rezultatet e detyrueshme në katër komponentët e tij, të cilat janë paraqitur në fotot më poshtë. Partnere në implementimin e projektit ishin Banka Qendrore e Gjermanisë dhe Banka Popullore e Kroacisë, të mbështetura nga bankat tjera qendrore të BE-së. Ky projekt 18 mujor u financua nga BE-ja, në një shumë prej 600.000 euro.



Aktivitetet e projektit në tremujorin e gjashtë

Në tremujorin e fundit të projektit, nga 15 dhjetori i vitit 2020 deri më 14 mars të vitit 2021 (16-18 muaj të projektit), u organizuan dhe zhvilluan me sukses nëntë misione eksperte virtuale dhe një vizitë studiu virtuale. Gjithashtu u zhvilluan edhe takimi i gjashtë dhe i shtatë i Bordit Drejtues të Projektit, punëtorja përfundimtare dhe punëtorja e qëndrueshmërisë, si dhe konferenca përfundimtare e projektit. Të gjithë këto aktivitete çuan në përfundimin e suksesshëm të projektit dhe arritjen e qëllimeve të përgjithshme dhe specifike, si dhe në arritjen e rezultateve të detyrueshme konkrete. Aktivitetet përfundimtare dhe nënaktivitetet si pas komponentëve janë paraqitur më poshtë.

Komponenti 1. SISTEMET E PAGESAVE DHE SHËRBIMET E PAGESAVE

Në tremujorin e fundit, u zhvilluan dy misione eksperte virtuale dhe një vizitë studiu virtuale.

Në kuadër të aktivitetit të dytë të këtij komponenti „Harmonizim i mëtejshëm i kornizës së politikave të shërbimeve të pagesave në BPRMV me direktivat dhe rregullat e BE-së në fushën e shërbimeve të pagesave“, ekspertë nga Banka Popullore e Kroacisë prezantuan aplikacione të TI-së për krahasimin e tarifave më të përfaqësuar të shërbimeve të pagesave. Tregu korat për shërbimet e pagesave është mjaft i ngjashëm me tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kështu që përvoja përkatëse kroate në zbatimin e Direktivës së Llogarive të Pagesave ishte shumë e dobishme, veçanërisht për shkak të kushteve dhe shërbimeve specifike të ofruara në dy tregjet. Misioni gjithashtu përfshiu edhe një prezantim publik të përvojës kroate për ofruesit e shërbimeve të pagesave, operatorët e shërbimeve të pagesave, universitetet dhe institucioneve financiare rregullatore.

Gjatë misionit, në kuadër të aktivitetit „Përmirësimi i kapacitetit në fushën e biznesit dhe informatikës lidhur me sistemet për shlyerjet bruto në kohë reale (RTGS), veçanërisht për TARGET 2 dhe TIPS dhe zbatimin e ISO20022 në sistemet e pagesave në Evropë“, ekspertë të Bankës Qendrore të Letonisë zhvilluan një mision ekspert me temë

„Infrastruktura e tregut financiar - roli operativ, mbikëqyrës, rregullator dhe zhvillues i Bankës së Letonisë“. Ata e analizuan qasjen në shërbimin për shlyerje në TARGET 2 dhe përpunimin e pagesave të çastit në TIPS, prezantuan përvojën në drejtimin e sistemit për pagesa të vogla CENTROLink dhe lidhjen e tij me infrastruktura tjera të tregut financiar që funksionojnë në kuadër të SEPA-së dhe shqyrtuan çështjet organizative lidhur me rolin operativ, mbikëqyrës, rregullator dhe zhvillimor të sistemeve të pagesave të përqendruara në departamentin e njëjtë të institucionit.

Në kuadër të aktivitetit të njëjtë, u realizua edhe një vizitë studiuëse virtuale në Bankën Qendrore të Gjermanisë, në të cilën 14 punonjës nga BPRMV-ja fituan njohuri nga ekspertët e Bankës Qendrore të Gjermanisë të cilët e prezantuan organizimin e aktiviteteve operative në TARGET 2 dhe TIPS. Duke bërë këtë, gjithashtu u përfshinë edhe tema lidhur me pranimin e ISO 2022 siç është hartëzimi i standardeve MT dhe MX, organizimin e test fazës zhvillimore të migritimit drejt ISO 2022 dhe çështje për menaxhimin e rreziqeve lidhur me pranimin e standardit të ri në porositë e pagesave.

Komponenti 2. MBIKËQYRJA DHE RREGULLORJA BANKARE

Në tremujorin e fundit të projektit, në kuadër të këtij komponenti u zhvilluan katër misione eksperte virtuale.

Në kuadër të aktivitetit të parë të këtij komponenti, „Zhvillimi i udhëzimeve të brendshme për vlerësimin e procesit të përcaktimit të likuiditetit të brendshëm të bankave (PIL) dhe integrimi i tyre në procesin e vlerësimit mbikëqyrës (SREP)“, u zhvilluan dy misione eksperte virtuale, një nga ekspertët e bankave qendrore të Gjermanisë dhe Holandës dhe një nga ekspertët e Bankës Popullore të Kroacisë. Gjatë misioneve të kombinuara të bankave qendrore të Gjermanisë dhe Holandës, ekspertët prezantuan rezultatet nga analizat e tyre për raportet e anonimizuara PIL, duke shkëmbyer pikëpamje me kolegët nga BPRMV-ja lidhur me interpretimin dhe vlerësimin e rezultateve. Ekspertët kroatë prezantuan, arsyetuan dhe shqyrtuan kornizën rregullatore kroate për vlerësimin e procesit të përcaktimit të likuiditetit të brendshëm, procesit për vlerësimin e PIL përmes prezantimit të parametrave praktike dhe integrimin e tij në SREP.

Në aktivitetin e tretë „Krijimi i kushteve për përmirësimin e mbledhjes së borxheve, menaxhim më të mirë dhe zgjidhjen e kredive me probleme dhe përmirësim të administrimit me rrezikun e përgjithshëm të bankave“, u kryen dy misionet virtuale nga ana e ekspertëve nga banka qendrore e Kroacisë, të cilët e përmbyllën punën e tyre me këtë temë. U bë një shqyrtim përfundimtar i propozim legjislativ, u identifikuan pjesët që kanë nevojë për përmirësim dhe u dakorduan propozimet për përmirësim.

Në misionin e fundit, u bë një propozim për ndryshimin e rregullores për administrimin e rrezikut të kredisë, i cili përmban udhëzime për bankat për të shitur ekspozimet e kredisë dhe u zhvillua një prezantim/punëtori publike me praktika më të mira lidhur me shitjen e ekspozimeve të kredisë në Kroaci, si dhe të atyre që do të përfshihen në legjislativonin e evropian.

Komponenti 3. STATISTIKA E LLOGARIVE FINANCIARE

Në tremujorin e fundit të projektit, dy misione virtuale u kryen nga ana e ekspertëve të bankave qendrore të Kroacisë dhe Rumanisë. Ata u përqendruan në çështjet e mbetura të TI-së dhe çështjet metodologjike për përgatitjen e llogarive financiare, si dhe për çështjet që nuk ishin mbuluar më parë. Gjatë misionit u bënë vërejtje përfundimtare për të gjithë procesin e përpilimit të të dhënave për llogaritë financiare dhe propozime për zhvillimin e ardhshëm. Në fund, ekspertët biseduan dhe analizuan përcaktimet e arritura (rezultatet e detyrueshme), të cilat së bashku me idetë e propozuara u përfshinë në raportin përfundimtar.

Komponenti 4. NJOHURI DHE AFTËSI NË ANALIZËN E POLITIKAVE

Gjatë tremujorit të gjashtë të projektit, u zhvillua një mision virtual përfundimtar nga ana e ekspertit të Bankës Popullore të Rumanisë. Në kuadër të tij, u shqyrtua situata momentale e punimit hulumtues dhe u përgatit versioni i tij final, duke përfshirë rekomandimet për zbatimin e konkluzioneve të tij. Gjithashtu, u përgatit edhe një ngjarje për shikueshmëri në kuadër të Klubit të Hulumtuesve të BPRMV-së.

NGJARJE PËR SHIKUESHMËRI DHE AKTIVITETE

Në tremujorin e fundit të projektit, u zhvillua nga një ngjarje për shikueshmëri për çdo komponent, si dhe një konferencë përfundimtare për projektin. Të gjithë ngjarjet u zhvilluan në mënyrë virtuale për shkak të pandemisë. Në komponentin 1, internet faqja për krahasimin e tarifave për përdoruesit u prezantua nga ana e ekspertëve të Bankës Popullore të Kroacisë më 18.12.2020. Në komponentin 2, më 26.2.2021, për përfaqësuesit e bankës u prezantua metodologjia e re ILAAP nga ana e ekspertëve të BPRMV-së, dhe ekspertët e Bankës Popullore të Kroacisë prezantuan përvojën e tyre me shitjen e kredive me probleme, si dhe rregullativën e re evropiane në këtë fushë. Ekspertë të BPRMV-së prezantuan të dhënat e fundit për llogaritë financiare, si dhe përparimin e arritur gjatë projektit të binjakëzimit të

mbështetur nga BE-ja përpara studentëve dhe profesorëve të Fakultetit Ekonomik, Entit Shtetëror të Statistikave dhe Ministrisë së Financave më 4.3.2021. Në kuadër të komponentit 4, ekspertë të BPRMV-së prezantuan punimin hulumtues „Modeli DSGE me euroizim të pjesshëm: rasti i ekonomisë maqedonase“ në një ngjarje të Klubit të Hulumtuesve më 5 mars të vitit 2021. Për të gjithë ngjarjet kishte njoftime të publikuara në internet faqen e BPRMV-së.

Konferenca përfundimtare e projektit



Konferenca në të cilën morën pjesë 62 mysafirë (pa llogaritur përfaqësuesit e BPRMV-së) u zhvillua më 11.3.2021, si një video konferencë përmes internetit. Ecuria e përgjithshme e projektit dhe arritja e rezultateve u prezantuan për të gjithë aktorët dhe publikun në formën e një njoftimi.

Fjalime mbajtën guvernatorja e Bankës Popullore, Anita Angelovska-Bezhoska, ambasadori i Delegacionit të BE-së, Dejvid Gir, ambasadorja e Republikës së Kroacisë, Nives Tiganj, guvernatori i Bankës Popullore të Kroacisë, Boris Vujçiq, anëtar i Bordit Ekzekutiv të Bankës Popullore të Gjermanisë, Burkard Balç dhe zëvendës shefi i Misionit të Ambasadës së Republikës së Gjermanisë, Oto Graf.

Pas fjalëve përshëndetëse, liderët e projektit, këshilltari i përhershëm për binjakëzim, si dhe liderët e komponentëve nga vendet anëtare dhe vendi përfitues prezantuan hollësitat e projektit dhe rezultatet e tyre specifike.

Përveç kësaj, u xhirua dhe prodhua një film për projektin i cili u nda me publikun në të njëjtën ditë të njoftimit për Konferencën Përfundimtare (12.3.2021). Filmi mund të shihet në lidhjen më poshtë, në kanalën e BPRMV-së në Youtube, dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes internet faqes dhe profilet e BPRMV-së në Facebook dhe Twitter.

<https://www.youtube.com/watch?v=SvBdDsrHMe0&t=6s>



Projekti mund të gjendet në artikullin e hollësishëm dhe të gjerë (10 faqe) botuar lidhur me të, në edicionin e prillit të vitit 2021 të revistës mujore „Ekonomija i biznes“. Artikulli ofron pikëpamje të ndryshme mbi projektin dhe prezanton rezultatet e tij.





НАРОДНА БАНКА НА
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Ky projekt është financuar nga Bashkimi
Evropian

Institucione për
implementim

Institucioni përfitues

Ky publikim është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e BPRMV-së dhe në asnjë mënyrë nuk i reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.